



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/148
Datë: 29.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, nenit 70 pika 2. të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës me Nr. Protokolli 1048 të datës 15.06.2023, jep mendim pozitiv lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin Nr. 08/L-239 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-128.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, vlerëson se nisma e Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas pikës 1. të këtij Vendimi, do të ndikojë në zhvillimin dhe hapjen e administratës publike ndaj profesionistëve, duke nxitur efikasitetin dhe transparencën edhe në procedurat e rekrutimit.
3. Opinioni i Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, opinioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe ai i Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit në kuptim të përputhshmërisë me Acquis të BE-së, i bashkëngjiten këtij Vendimi dhe i procedohen Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë